Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo
SEKRETARIATI I KËSHILLIT GJYQËSOR I KOSOVËS
SEKRETARIJAT SUDSKOG SAVETA KOSOVA
KOSOVO JUDICIAL COUNCIL SECRETARIAT
Nr.Br.No. 06 / 731
DAT.DT. 18. 08. 20
PRISHTINË

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

**SEKRETARIATI – SEKRETARIJAT - SECRETARAIT**

| | |
|---|---|
| **PËR:** | Florim Beqiri,<br>Drejtor i Departamentit të Auditimit,Zyra Kombëtare e Auditimit |
| **PËRMES:** | |
| **PREJ:** | Shkëlzen Maliqi,<br>Drejtor i Përgjithshëm,Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës |
| **KOPJE:** | Skender Çoçaj,<br>Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës |
| **LËNDA:** | Plani i Veprimit për Implementim të Rekomandimeve për vitin 2019 |
| **DATA:** | 18 Gusht 2020 |

I nderuari z.Beqiri,

Të bashkangjitur keni Planin e Veprimit për Implementim të Rekomandimeve për vitin 2019 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës i cili plan do të monitorohet në vazhdimësi gjatë vitit 2020 si dhe do të përgaditen raportet periodike të progresit për zbatimin e këtyre rekomandimeve.

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE
20. 08. 2020

| Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit | Shif.klasif. Klasif. Kod Class. Code | Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No | Nr. i faqeve Br. Strana No. Pages |
|---|---|---|---|
| 05 | 47 | 1510 | 4 |

**Plani i Veprimit për Implementim të Rekomandimeve lidhur me Raportin e Auditimit të Pasqyrave Financiare të KGjK-së për vitin 2019**

| Nr | Rekomandimi i ZKA | Komentet dhe Veprimet e Menaxhmentit | Afati kohor për zbatim | Zyrtari përgjegjës për zbatim | Vërejtje |
|---|---|---|---|---|---|
| **ÇËSHTJA A1** **Mos harmonizimi i pagesës me aktet e emërimit** | Rekomandimi A1: Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës të siguroj se departamenti i burimeve njërzore do të bëjë azhurnimin (ndryshimin) e akt emërimeve në pajtim me vendimin e Këshillit. | Lidhur me këtë çështje dhe rekomandim një nder arsyet e mos ndryshimit të Akt emërimeve lidhet edhe me hyrjen ne fuqi të Ligjit për Paga dhe në ndërkohë Vendimit të Gjykatës Kushtetuese për pezullim të ligjit. Pas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, SKGJK do të ndërmerr të gjithe hapat lidhur me azhurnimin e Akt emërimeve sipas legjislacionit në fuqi. | Tremujori IV-2020 | Menaxhmenti i KGjK-së dhe SKGjK-së | |
| **ÇËSHTJA A2** **Mungesa e evidencave për vijueshmëri në punë** | Rekomandimi A2: Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës duhet të siguroj funksionimin elektronik të vijueshmërisë, ndërsa në rast të mosfunksionimit të mbahen evidenca të vijueshmërisë në formë fizike në mënyrë që të dëshmohet prezenca e punonjësve në punë. | Lidhur me këtë çështje dhe rekomandim kemi pasur problem me sistemin elektronik të vijueshmërisë në punë në Gjykaten Themelore të Prizrenit ,por ky problem tashmë është zgjidh dhe ky rekomandim mund të konsiderohet i zbatuar. | Tremujori II-2020 | Menaxhmenti i KGjK-së,SKGjK-së dhe i Gjykatave. | |
| **ÇËSHTJA A3** **Parregullsi gjatë procesit të rekrutimit** | Rekomandimi A3: Kryesuesi i KGJK-së të siguroj se procedurat e rekrutimit zbatohen në përputhje me rregulloren në fuqi ku pas çdo procesi të testimit dhe intervistimit do të përgaditet raporti me shkri për menaxherin e personelit. | Të gjitha parregullesit e evidentuara gjatë procesit të rekrutimit do të merren në konsideratë në procedurat e ardhshme të rekrutimit dhe do të zbatohen sipas legjislacionit në fuqi. | Tremujori III-2020 | Kryesuesi i KGjK-së dhe Drejtori i Sekretarit të KGjK-së. | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **ÇËSHTJA A4**<br><br>**Ndarje jo e duhur e detyrave** | Rekomandimi A4:<br>Kryesuesi i KGJK-së duhet të siguroj se zyrtarët të cilët janë të përfshirë në hartimin e specifikave nuk caktohen në vlerësimin e tenderëve si dhe këta të fundit nuk mund të angazhohen në menaxhimin e kontratës. | Këtë të gjetur e konsiderojm si lëshim teknik,edhe pse për këtë aktivitet të prokurimit të cekur në këtë çështje dhe rekomandim nuk kemi patur obligim ligjor të zhvillojm procedur të hapur të prokurimit për shkak se sipas Ligjit Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.<br><br>Neni 3 Përjashtimet Pika 6 Ky ligj nuk do të zbatohet për një kontrate të punësimit, nëse aktiviteti i tillë i prokurimit është lëndë e rregullave të tjera që vendosen me një ligj ose rregullore tjetër.<br><br>**Njëjtë, ligji aktual nuk do të aplikohet për kontratat në lidhje me trajnimet pasuniversitare apo trajnime profesionale nga punëdhënësit për zhvillimin e aftësive specifike të punëtorëve individualë.**<br>Për më shumë, ligji nuk do të aplikohet në prokurim ekskluzivisht të orientuar në përfaqësimin në formë të ofrimit të ushqimit dhe pijeve.<br><br>Andaj. Autoriteti Kontraktues: Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ka pas mundësi te beje një Marrëveshje ne Bashkëpunimit , me një nga Institucionet ne Republikën e Kosovës, te cilat ofrojnë Trajnimeve profesionale në fushën e TIK, për stafin e TI, te KGJK-se, pa | Tremujori III-2020 | Kryesuesi i KGjK-së dhe Drejtori i Sekretarit të KGjK-së. | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | zhvilluar fare procedure te hapur te prokurimit,prandaj ky rekomandim do të zbatohet në tërësi gjatë vitit 2020. | | | |
| **ÇËSHTJA B1**<br><br>**Mo inventarizim i plotë i pasurive në KGjK** | Rekomandimi B1:<br>Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës që komisioni i inventarizimit para përgaditjes së RVF të bëjë inventarizimin e të gjitha pasurive në KGjK dhe të përgadis raportin që ndërlidhet me procesin e inventarizimit. | Edhe pse kemi bërë përpjekje të vazhdueshme duke angazhuar edhe një komision për të mbikqyrur punën dhe për të këshilluar komisionet e inventarizmit nëpër gjykata,edhe këtë vit tri gjykata nuk e kanë përfundu inventarzimin,do të vazhdojm që të angazhohemi maksimalisht që në të ardhmen të gjitha gjykatat të përfundojn inventarizimin në mënyrë që të kemi regjistrin e plotë dhe të harmonizuar të pasurisë dhe të zbatojm këtë rekomandim deri në fund të vitit 2020. | Tremujori IV-2020 | Menaxhmenti i KGjK-së dhe SKGjK-së | |

Shkëlzen Maliqi, për [signature]
Drejtor i Përgjithshëm i Sekretariatit të KGjK-së

Datë: 18.08.2020

SEKRETARIATI I KËSHILLIT GJYQËSOR I KOSOVËS • PRISHTINË • SEKRETARIJAT SUDSKOG SAVETA KOSOVA • KOSOVO JUDICIAL COUNCIL SECRETARIAT